DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Has është përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e shërbimeve që lidhen me pastrimin, mirëmbajtjen, ndriçimin dhe administrimin e hapësirave publike, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kjo drejtori punon në bashkëpunim me njësitë administrative, institucionet vendore dhe komunitetin, për të garantuar një mjedis të pastër, të sigurt dhe funksional.

1. Sektori i Pastrimit dhe Gjelbërimit

Ky sektor mbulon shërbimet e pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve urbane:

- Pastrimi ditor i rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike
- Pastrimi i lulishteve, parqeve dhe hapësirave të gjelbëruara
- Pastrimi i tregjeve, institucioneve publike
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave
- Pastrimi i zonave periferike dhe akseve rrugore rurale
- Pastrimi përgjatë rrugëve nacionale dhe segmenteve kryesore
- Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i mbetjeve urbane
- Vendosja, zëvendësimi dhe mirëmbajtja e koshave të mbeturinave
- Organizimi i aksioneve të pastrimit në bashkëpunim me komunitetin
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbajtjen pastër të mjedisit

2. Sektori i Mirëmbajtjes

Ky sektor kujdeset për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës publike:

- Mbjellja sezonale e pemëve, luleve dhe bimësisë dekorative

- Krasitja dhe mirëmbajtja e pemëve dekorative dhe frutore
- Mirëmbajtja e lulishteve (kositjeje bari, vaditje, pastrim)
- Mirëmbajtja e fushave sportive
- Riparime të vogla në infrastrukturë (trotuare, bordura, elementë urbanë)
- Sistemimi i hapësirave publike dhe rikualifikimi i zonave të dëmtuara
- Mirëmbajtja e objekteve publike në varësi të bashkisë
- Ndërhyrje në raste festash, aktivitetesh dhe eventesh publike
- Vendosja e elementeve dekorative dhe sezonale në qytet

3. Sektori i Kanalizimeve dhe Ujërave të Zeza dhe të Bardha

Ky sektor siguron funksionimin normal të rrjeteve të kanalizimeve:

- Pastrimi dhe mirëmbajtja periodike e puseve dhe kolektorëve
- Zhbllokimi i rrjeteve të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe të bardha
- Pastrimi i kanaleve kulluese dhe kanaleve anësore të rrugëve
- Parandalimi i përmbytjeve përmes mirëmbajtjes së rrjetit
- Ndërhyrje emergjente në raste bllokimesh apo reshjesh intensive
- Identifikimi i problematikave dhe raportimi për ndërhyrje të mëtejshme

4. Sektori i Elektrikut të Qytetit

Ky sektor merret me administrimin e ndriçimit publik:

- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik
- Mirëmbajtja e shtyllave, kabllove dhe ndriçuesve
- Riparimi i defekteve dhe zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara
- Vendosja e ndriçimit në zona të reja dhe të pa mbuluara
- Kontrolli periodik i funksionimit të rrjetit të ndriçimit
- Optimizimi i konsumit të energjisë dhe përdorimi i ndriçimit eficient (LED)

5. Funksione shtesë të Drejtorisë

- Hartimi i planeve mujore dhe vjetore të punës
- Monitorimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe mjeteve të punës
- Bashkëpunimi me institucione të tjera për çështje mjedisore dhe infrastrukturore
- Trajtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve
- Raportimi periodik pranë drejtuesve të bashkisë
- Zbatimi i legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe shërbimet publike